



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**K.DH.SH.II.nr.323/22**

**GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË** - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtaren Faranciska Zhitija –Ymeri, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit KS “I...” , me seli në Prishtinë, adresa rr. “...” nr...., ndaj debitorit “M.... Company” SH.P.K, nga Klina rr.”...” i përfaqësuar sipas autorizimit nga Shoqëria e Avokatëve “Legus” shpk nga Prishtina, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Klinë, CPP.nr.62/21 të datës 11.08.2021, me datën; 09.11.2022, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** e pabazuar ankesa e debitorit “M.... Company” SH.P.K, nga Klina rr. “...” nga Prishtina, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Klinë CPP.nr.62/21 të datës 11.08.2021, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Pejë – Dega në Klinë, me aktvendimin e ankimuar CPP.nr.62/21 të datës 11.08.2021, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit M.... Company” SH.P.K, nga Klina rr.”...”, i paraqitur kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit të Përmbaruesit Privat Kushtrim Metaj, për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë P.nr.173/21, të datës 23.03.2021.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak te cenimit thelbësor te dispozitave te procedurës kontestimore dhe përmbarimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën si të bazuar, aktvendimin e shkallës së parë ta ndryshoj ose ta anuloj dhe çështjen ta kthej në rivendosje ndërsa urdhrin për përmbarim ta anuloj si të palejueshëm.

Kreditori nuk ka paraqit përgjigje në ankesën e debitorit.

Dhoma e Shkalles së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

**Ankesa e debitorit është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturave me nr.11/18 dt.18.12.2018, 71/18 dt.17.09.2018, nr.99/18 dt.16.10.2018, nr.102/18 dt.05.11.2018, nr.105/18 dt.08.11.2018, nr.122/18 dt.219.11.2018, nr.123/18 dt.29.11.2018, nr. 127/18 dt.10.12.2018, nr.02/19 dt.09.01.2019, nr.05/19 dt.30.01.2019, nr.06/19 dt.30.01.2019. Përmbartuesi privat Kushtrim Metaj nga Prishtina, sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbartimor P.nr.173/2021 të datës 23.03.2021, ka lejuar përmbartimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit për pagesën e policave, t'i paguaj shumën në total prej 2,718.14 euro.

Kundër urdhrin përmbartimor debitori ka paraqitur prapësim me datë 06.04.2021, duke theksuar se propozimi për përmbartim është i palejueshëm sepse nuk janë plotësuar kushtet ligjore në bazë të nenit 37 par.1 të LPP, fatura e cila i është bashkangjitur propozimit për përmbartim nuk është origjinal ose kopje e vërtetuar siç përcaktohet me dispozitat ligjore. Po ashtu propozimi për përmbartim është në kundërshtim me nenin 38 par.1 të LPP sepse kreditori nuk është i njëjtë si në propozimin për përmbartim dhe në bazë të faturave të bashkangjitura këtij propozimi sepse në bazë të propozimit kreditori është K.S I... –NE LIKUIDIM, po ashtu thekson se të gjitha faturat janë paguar me para të gatshme nga agjenti i KS I... i autorizuar për këtë rast, propozon që gjykata ta aprovoj prapësimin e debitorit, ta anuloj urdhrin për përmbartim dhe ta detyroj palën kreditore ti paguaj shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Gjykata Themelore në Pejë - Dega në Klinë, pas vlerësimit të prapësimin, ka nxjerrë aktvendimin CPP.nr.62/21 të datës 11.08.2021, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar. Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar ka theksuar se prapësimi i debitorit është i pabazuar sepse debitori nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme për ta bindur gjykatën që urdhri përmbartimor duhet të anulohet, dëshmitë e ofruara nuk janë të kuptueshme, ndërsa debitori ka theksuar se policat e sigurimit nuk janë origjinal apo kopje e vërtetuar gjë që nuk qëndron sepse gjykata në shkresat e lëndës i ka faturat konkretisht policat e sigurimit në origjinal dhe në kopje e kjo shihet në bazë të dokumentit të besueshëm –Fatura dhe Polica e sigurimit, ashtu që ka vendosur si në dispozitiv.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin të përmbartuesit privat, me të cilin është caktuar përmbartimi i propozuar nga kreditori, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate

me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarimi është lejuar në bazë të faturave të lëshuara nga kreditori, në mbështetje të nenit 29 paragrafi 1 pika 1.3 të LPP-së, këto fatura kanë cilësinë e dokumentit të besueshëm dhe të njëjtat si të tilla paraqesin bazë juridike për caktimin e përmbarimit, ashtu siç përcaktohet me dispozitën e nenit 21 të njëjtit ligj. Propozimi për përmbarim i ushtruar nga kreditori, po ashtu rezulton të jetë në pajtim me nenin 37 të LPP-së e cila thotë se *“kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimi të bashkëngjitet dokumenti i tillë në origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”* çka edhe gjykata shkallës së dytë vlerëson se kreditori ka vepruar pajtim me këtë nen, e kjo duke vepruar sipas dokumentit të besueshëm-faturave, në bazë të së cilave është caktuar përmbarimi.

Në rastin konkret Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK dhe se e as në konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Kjo gjykatë po ashtu vlerëson se në bazë të dokumentit të besueshëm-faturave, të cilat kreditori ia ka bashkëngjitur me rastin e ushtrimit të propozimit për përmbarim, janë plotësuar kushtet ligjore për caktimin e përmbarimit të propozuar nga kreditori, ngase faturat nr.11/18 dt.18.12.2018, 71/18 dt.17.09.2018, nr.99/18 dt.16.10.2018, nr.102/18 dt.05.11.2018, nr.105/18 dt.08.11.2018, nr.122/18 dt.219.11.2018, nr.123/18 dt.29.11.2018, nr.127/18 dt.10.12.2018, nr.02/19 dt.09.01.2019, nr.05/19 dt.30.01.2019, nr.06/19 dt.30.01.2019 në bazë të së cilave është caktuar përmbarimi, ligjërisht paraqesin bazë juridike për caktimin e përmbarimit e të cilat derivojnë nga policat e sigurimit e të cilat gjithashtu janë të pranuar, nënshkruara dhe vulosura nga debitori. Sa i përket faturës nr.127/18 e datës 10.12.2018 kjo gjykatë vlerëson se kjo faturë rrjedh nga polica e sigurimit nr.127/18 e datës 10.12.2018, e cila policë është e nënshkruar dhe vulosur nga debitori çka me nënshkrimin dhe pranimin e kësaj police nga e cila derivon fatura konsiderohet se debitori ka pranuar detyrimet ndaj kreditorit andaj edhe si e tillë kjo faturë plotëson kushtet për përmbarim. Pretendimi i debitorit se të gjitha faturat janë paguar me para të gatshme nga agjenti i KS I..., është i pabazuar sepse debitori nuk ka ofruar asnjë provë ose dëshmi se i ka bërë këto pagesa, në cilën datë, muaj ose vit janë bërë pagesat apo cili është emri i agjentit i cili ka bërë pagesat. Kjo gjykatë analizoi edhe pretendimet tjera të debitorit por të njëjtat mbetën vetëm të natyrës deklarative dhe si të tilla edhe kjo gjykatë i refuzoi si të pabazuara pasi debitori nuk ka ofruar prova juridikisht të vlefshme në mbështetje të tyre konform nenit 69 par.5 të LPP, ndërsa vlerësoi se nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet ligjore nga neni 71 të LPP.

Përndryshe, në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin. Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përmbartimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes se përmbartimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt civil pranë gjykatës kompetente, ngase një pretendim i tillë i tij, nuk paraqet bazë ligjore për ndaljen, pezullimin apo përfundimin e përmbartimit në këtë rast.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË,  
DHOMA E SHKALLES SE DYTË  
K.DH.SH.II nr.323/22, me datë 09.11.2022

Gjyqtarja,  
Franciska Zhitija-Ymeri